<p>në zhvillimin e materialeve dhe metodologjive udhëzuese, mbështetjen e organizimit të ushtrimeve për të testuar qëndrueshmërinë e tyre dhe ofrimin e këshillave dhe trajnimeve për personelin e entiteteve kritike.</p> <p>2. Pa paragjykuar rregullat e zbatueshme për ndihmën shtetërore, institucionet shtetërore mund të ofrojnë mbështetje financiare për entitetet kritike, kur është e nevojshme dhe e justifikuar për qëllim të interesit publik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Bashkëpunimi ndërkombëtar</p> <p>1. Institucionet shtetërore bashkëpunojnë me shtetet tjera dhe me organizatat ndërkombëtare në lidhje me entitetet kritike për të siguruar zbatim të plotë të këtij ligji. Bashkëpunimi zhvillohet, në veçanti, në lidhje me entitetet kritike që:</p> <p>1.1. përdorin infrastrukturën kritike e cila është e lidhur fizikisht me dy ose më shumë shtete;</p> <p>1.2. janë pjesë e strukturave të korporatës që janë të lidhura ose të lidhura me entitete kritike në shtetet e tjera;</p> <p>1.3. janë identifikuar si entitete kritike në një shtet tjetër dhe ofrojnë shërbime esenciale për ose në Republikën e Kosovës.</p>	<p>development of guidance materials and methodologies, supporting the organization of exercises to test their resilience and providing advice and training for the personnel of critical entities.</p> <p>2. Without prejudice to the rules applicable to state aid, state institutions may provide financial support to critical entities when necessary and justified for the purpose of public interest.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 International cooperation</p> <p>1. State institutions shall cooperate with other states and with international organizations regarding critical entities to ensure full implementation of this law. Cooperation shall take place, in particular, in relation to critical entities that:</p> <p>1.1. use critical infrastructure that is physically connected to two or more countries;</p> <p>1.2. are part of corporate structures that are connected or related to critical entities in other countries;</p> <p>1.3. have been identified as critical entities in another state and provide essential services to or in the Republic of</p>	<p>materijala i metodologjive, podršku organizaciji vežbi za testiranje njihove održivosti i pružanje savete i obuka za osoblje kritičnih subjekata.</p> <p>2. Bez prejudiciranja primenjivih pravila za državnu pomoć, državne institucije mogu pružati finansijsku podršku kritičnim subjektima, kada je to potrebno i opravdano u cilju javnog interesa.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Međunarodna saradnja</p> <p>1. Državne institucije saraduju sa drugim zemljama i sa drugim međunarodnim institucijama u vezi sa kritičnim subjektima za obezbeđivanje potpunog sprovođenja ovog zakona. Saradnja se sprovodi, posebno, u vezi sa kritičnim subjektima koji:</p> <p>1.1. koriste kritičnu infrastrukturu koja je fizički povezana sa dve ili više zemlje;</p> <p>1.2. su deo struktura korporacija koja su povezana ili su povezana sa kritičnim subjektima u drugim zemljama;</p> <p>1.3. su identifikovani kao kritični subjekti u drugoj zemlji i pružaju osnove usluge za ili u Republici Kosovo.</p>
--	---	---

<p>2. Autoriteti kompetent shërben si pikë kontakti për të gjitha çështjet në lidhje me mbrojtjen e infrastrukturës kritike të Republikës së Kosovës, dhe udhëheq projektet e bashkëpunimit për mbrojtjen e infrastrukturës kritike me institucionet e sigurisë, institucionet qeveritare dhe joqeveritare, pronarët dhe operatorët publikë dhe privatë dhe akterët kryesor ndërkombëtarë në identifikimin, menaxhimin dhe zvogëlimin e rreziqeve për infrastrukturën kritike.</p> <p>3. Detyrimet për shkëmbimin e informacioneve me vendet e tjera nuk përfshijnë ofrimin e informacionit, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me interesat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mbrojtjes së Republikës së Kosovës.</p> <p>KAPITULLI III QËNDRUESHMËRIA E ENTITETEVE KRITIKE</p> <p>Neni 13 Strategjia për qëndrueshmëri të entiteteve kritike</p> <p>1. Autoriteti kompetent harton strategjinë për rritjen e qëndrueshmërisë së entiteteve kritike, përmes së cilës përcaktohen objektivat</p>	<p>Kosovo.</p> <p>2. The competent authority shall serve as the point of contact for all matters related to the protection of the critical infrastructure of the Republic of Kosovo and shall lead cooperation projects for the protection of critical infrastructure with security institutions, governmental and non-governmental institutions, public and private owners and operators, and main international actors in identifying, managing and mitigating risks to critical infrastructure.</p> <p>3. Obligations for the exchange of information with other countries do not include the provision of information the disclosure of which would be contrary to the interests of national security, public safety or defense of the Republic of Kosovo.</p> <p>CHAPTER III RESILIENCE OF CRITICAL ENTITIES</p> <p>Article 13 Strategy on resilience of critical entities</p> <p>1. The competent authority shall draw up the strategy for increasing the resilience of critical entities laying down strategic objectives and</p>	<p>2. Nadležni organ služi kao kontakt tačka za sva pitanja u vezi sa zaštitom kritične infrastrukture Republike Kosovo, i vodi projekte saradnje za zaštitu kritične infrastrukture sa bezbednosnim institucijama, vladinim i nevladinim institucijama, javnim i privatnim vlasnicima i operaterima i glavnim međunarodnim akterima u identifikaciji, upravljanju i smanjenju rizika za kritičnu infrastrukturu.</p> <p>3. Obaveze za razmenu informacija sa drugim zemljama ne obuhvataju pružanje informacija, čije bi otkrivanje bilo u suprotnosti sa interesima nacionalne bezbednosti, javne bezbednosti ili odbrane Republike Kosovo.</p> <p>POGLAVLJE III ODRŽIVOST KRITIČNIH SUBJEKATA</p> <p>Član 13 Strategjia održivosti kritičnih subjekata</p> <p>1. Nadležni organ izrađuje strategiju povećanja održivosti kritičnih subjekata, kroz koju se utvrđuju strateški ciljevi i mere</p>
---	--	---

<p>strategjikë dhe masat e politikave, duke u mbështetur në strategjitë, planet ose dokumente të ngjashme ekzistuese kombëtare dhe sektoriale, me synimin për të arritur dhe mbajtur një nivel të lartë të qëndrueshmërisë nga ana e entiteteve kritike.</p> <p>2. Strategjia duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtëm:</p> <p>2.1. objektivat dhe prioritetet strategjike për qëllime të rritjes së qëndrueshmërisë së përgjithshme të entiteteve kritike, duke marrë parasysh varësitë dhe ndërvarësitë ndërkufitare dhe ndër-sektoriale;</p> <p>2.2. një kornizë udhëheqëse për të arritur objektivat dhe prioritetet strategjike, duke përfshirë përshkrimin e roleve dhe përgjegjësisive të autoriteteve të ndryshme, entiteteve kritike dhe palëve të tjera të përfshira në zbatimin e strategjisë;</p> <p>2.3. një përshkrim të masave të nevojshme për të rritur rezistencën e përgjithshme të subjekteve kritike, duke përfshirë një përshkrim të vlerësimit të sipas nenit 8 të këtij ligji;</p> <p>2.4. një përshkrim të procesit me të cilin identifikohen entitetet kritike;</p>	<p>policy measures, in accordance with existing national and sectoral strategies, plans or similar documents, with the aim of achieving and maintaining a high level of resilience of critical entities.</p> <p>2. The strategy shall contain at least the following elements:</p> <p>2.1. strategic objectives and priorities for the purpose of enhancing the overall resilience of critical entities, taking into account cross-border and cross-sectoral dependencies and interdependencies;</p> <p>2.2. a guiding framework to achieve the strategic objectives and priorities, including the description of the roles and responsibilities of the various authorities, critical entities and other parties involved in the implementation of the strategy;</p> <p>2.3. a description of the measures necessary to increase the general resilience of critical entities, including a description of the assessment according to Article 8 of this law;</p> <p>2.4. a description of the process whereby critical entities are identified;</p>	<p>politike, oslanjajući se na slične postojeće nacionalne i sektorske strategije, planove ili dokumente, sa ciljem postizanja i održavanja visokog nivoa održivosti od strane kritičnih subjekata.</p> <p>2. Strategija treba da sadrži najmanje sledeće elemente:</p> <p>2.1. strateške ciljeve i prioritete u cilju povećanja ukupne održivosti kritičnih subjekata, uzimajući u obzir prekogranične i međusektorske zavisnosti i međuzavisnosti;</p> <p>2.2. upravljački okvir za postizanje strateških ciljeva i prioriteta, uključujući opis uloga i odgovornosti različitih organa, kritičnih subjekata i drugih strana uključenih u sprovođenje strategije;</p> <p>2.3. opis neophodnih mera za povećanje opšteg otpora kritičnih subjekata, uključujući opis procene u skladu sa članom 8. ovog zakona;</p> <p>2.4. opis procesa kojim se identifikuju kritični subjekti;</p>
--	--	--

<p>2.5. një përshkrim të procesit të mbështetjes së entiteteve kritike, duke përfshirë masat për të rritur bashkëpunimin ndërmjet sektorit publik, nga njëra anë, dhe sektorit privat dhe subjekteve publike dhe private, nga ana tjetër;</p> <p>2.6. një listë të autoriteteve kryesore dhe palëve të interesuara, të ndryshme nga entitetet kritike, të përfshira në zbatimin e strategjisë;</p> <p>2.7. një kornizë politike për koordinimin ndërmjet autoriteteve kompetente për qëllime të shkëmbimit të informacionit mbi rreziqet e sigurisë kibernetike, kërcënimet kibernetike, incidentet kibernetike, rreziqet jo-kibernetike, kërcënimet dhe incidentet dhe ushtrimi i detyrave mbikëqyrëse;</p> <p>2.8. një përshkrim të masave tashmë të vendosura të cilat synojnë të lehtësojnë zbatimin e detyrimeve sipas këtij ligji nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.</p> <p>3. Pas konsultimit me të gjitha palët e interesuara përkatëse, autoriteti kompetent përditësojnë strategjinë të paktën çdo katër (4) vjet.</p>	<p>2.5. a description of the process of supporting critical entities, including measures to increase cooperation between the public sector, on the one hand, and the private sector and public and private entities, on the other hand;</p> <p>2.6. a list of key authorities and stakeholders, other than critical entities, involved in the implementation of the strategy;</p> <p>2.7. a policy framework for coordination between competent authorities for the purpose of sharing information on cyber security risks, cyber threats, cyber incidents, non-cyber risks, threats and incidents and the exercise of supervisory duties;</p> <p>2.8. a description of the measures already in place which aim to facilitate the implementation of the obligations under this law by small and medium-sized enterprises.</p> <p>3. After consultation with all relevant stakeholders, the competent authority shall update the strategy at least every four (4) years.</p>	<p>2.5. opis procesa podrške kritičnim subjektima, uključujući mere za povećanje saradnje između javnog sektora, s jedne strane, i privatnog sektora i javnih i privatnih subjekata, s druge strane;</p> <p>2.6. listu sa glavnim organima zainteresovanih strana, različiti od kritičnih subjekata, uključenih u sprovođenju strategije;</p> <p>2.7. okvir politike za koordinaciju između nadležnih organa u cilju razmene informacija o rizicima sajber bezbednosti, sajber pretnjama, sajber incidentima, ne-sajber rizicima, pretnjama i incidentima i obavljanju nadzornih dužnosti;</p> <p>2.8. opis već ustanovljenih mera koje imaju za cilj da olakšavaju primenu obaveza u skladu sa ovim zakonom od strane malih i srednjih preduzeća.</p> <p>3. Nakon konsultacija da svim relevantnim zainteresovanim stranama, nadležni organ ažurira strategiju najmanje svake četiri (4) godine.</p>
---	---	---

<p align="center">Neni 14 Vlerësimi i rrezikut nga entitetet kritike</p>	<p align="center">Article 14 Risk assessment by critical entities</p>	<p align="center">Član 14 Procena rizika od kritičnih subjekata</p>
<p>1. Autoriteti kompetent siguron që entitetet kritike kryejnë vlerësimin e rrezikut brenda nëntë (9) muajve nga marrja e njoftimit se janë pjesë e listës së infrastrukturës kritike.</p> <p>2. Entiteti kritik kryen vlerësimin e rrezikut, të paktën çdo katër (4) vjet dhe kurdoherë që është e nevojshme, në bazë të vlerësimeve shtetërore të rrezikut dhe burimeve të tjera të rëndësishme të informacionit, për të vlerësuar të gjitha rreziqet përkatëse që mund të pengojnë ofrimin e shërbimeve esenciale.</p> <p>3. Vlerësimet e rrezikut të entitetit kritik duhet të marrin parasysh të gjitha rreziqet përkatëse natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu që mund të çojnë në një incident, duke përfshirë ato të natyrës ndërsektoriale ose ndërkufitare, aksidentet, fatkeqësitë natyrore, emergjencat e shëndetit publik, kërcënimet hibride, si dhe kërcënimet tjera armiqësore, duke përfshirë rreziqet nga terrorizmi.</p> <p>4. Vlerësimi i rrezikut të një entiteti kritik duhet të marrë parasysh shkallën në të cilën sektorët e tjerë të përcaktuar varen nga shërbimi esencial i ofruar nga entiteti kritik dhe sa ai entitet kritik varet nga shërbimet esenciale të ofruara nga entitete tjera në të tjera sektorë,</p>	<p>1. The competent authority shall ensure that critical entities carry out a risk assessment within nine (9) months of receiving notification that they are part of the critical infrastructure list.</p> <p>2. The critical entity shall conduct the risk assessment at least every four (4) years and whenever necessary, based on state risk assessments and other relevant sources of information, to assess all relevant risks that may impede the provision of essential services.</p> <p>3. Critical entity risk assessments should account for all relevant natural and man-made risks which could lead to an incident, including those of a cross-sector or cross-border nature, accidents, natural disasters, public health emergencies, hybrid threats , as well as other hostile threats, including terrorism threats.</p> <p>4. The risk assessment of a critical entity should consider the extent to which other designated sectors depend on the essential service provided by the critical entity and how much that critical entity depends on essential services provided by other entities in other</p>	<p>1. Nadležni organ obezbeđuje da kritični subjekti vrše procenu rizika u roku od devet (9) meseci od prijema obaveštenja da su deo liste kritične infrastrukture.</p> <p>2. Kritični subjekat vrši procenu rizika, najmanje svake četiri (4) godine i kad god je potrebno, na osnovu državnih procena rizika i drugih relevantnih izvora informacija, za procenu svih relevantnih rizika koji mogu sprečiti pružanje osnovnih usluga.</p> <p>3. Procene rizika kritičnog subjekta treba da uzmu u obzir sve relevantne prirodne rizike i rizike koje je prouzrokovao čovek koji bi mogli da dovedu do incidenta, uključujući one međusektorske ili prekogranične prirode, incidente, prirodne nepogode, vanredne situacije u javnom zdravlju, hibridne pretnje, kao i druge neprijateljske pretnje, uključujući pretnje od terorizma.</p> <p>4. Procena rizika od kritičnog subjekta treba da uzme u obzir u kojoj meri drugi određeni sektori zavise od osnovne usluge koju pruža kritični subjekat i koliko taj kritični subjekat zavisi od osnovnih usluga koje pružaju drugi subjekti u drugim sektorima, uključujući, ako</p>

<p>duke përfshirë nëse është e nevojshme, në shtetet fqinje dhe shtetet tjera.</p> <p>5. Kur një entitet kritik ka kryer vlerësime të tjera të rrezikut ose ka hartuar dokumente në përputhje me detyrimet e përcaktuara në akte të tjera ligjore që janë të rëndësishme për vlerësimin e rrezikut, ai mund t'i përdorë ato vlerësime dhe dokumente për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në këtë nen.</p> <p>6. Autoriteti kompetent mund të konsiderojë një vlerësim ekzistues të rrezikut të kryer nga një entitet kritik që trajton rreziqet dhe shtrirjen e varësisë të përmendur në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni si në përputhje, tërësisht ose pjesërisht, me detyrimet sipas këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Masat e qëndrueshmërisë të entiteteve kritike</p> <p>1. Autoriteti kompetent siguron që entitetet kritike të marrin masat e duhura dhe proporcionale teknike, të sigurisë dhe organizative për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre, bazuar në vlerësimin shtetëror të rrezikut dhe mbi rezultatet e vlerësimit të rrezikut të entitetit kritik, duke përfshirë masat nevojshme si më poshtë:</p>	<p>sectors, including if necessary, in neighboring countries and other countries.</p> <p>5. When a critical entity has carried out other risk assessments or drafted documents in accordance with the obligations set out in other legal acts that are relevant to the risk assessment, it may use those assessments and documents to meet the requirements defined in this article.</p> <p>6. The competent authority may consider an existing risk assessment carried out by a critical entity that addresses the risks and extent of dependence referred to in paragraphs 3 and 4 of this Article as being in compliance, in whole or in part, with the obligations under this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Resilience measures of critical entities</p> <p>1. The competent authority shall ensure that the critical entities take appropriate and proportionate technical, security and organizational measures to ensure their viability, based on the state risk assessment and on the results of the risk assessment of the critical entity, including the necessary measures below:</p>	<p>je potrebno, u susednim zemljama i drugim zemljama.</p> <p>5. Kada je kritični subjekat vršio druge procene rizika ili izradio dokumente u skladu sa obavezama utvrđenim drugim pravnim aktima koji su relevantni za procenu rizika, on može koristiti te procene i dokumente da ispuni uslove utvrđene ovim članom.</p> <p>6. Nadležni organ može smatrati da je postojeća procena rizika koju je izvršio kritični subjekat, a koja se bavi rizicima i obimom zavisnosti iz stava 3. i 4. ovog člana, u potpunosti ili delimično u skladu sa obavezama iz ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Održive mere kritičnih subjekata</p> <p>1. Nadležni organ obezbeđuje da kritični subjekti preduzmu odgovarajuće i srazmerne tehničke, bezbednosne i organizacione mere kako bi obezbedili svoju održivost, na osnovu državne procene rizika i rezultata procene rizika kritičnog subjekta, uključujući sledeće neophodne mere:</p>
--	--	---

<p>1.1. për parandalimin e incidenteve, duke marrë parasysh në mënyrë të duhur masat për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe përshtatjen klimatike;</p> <p>1.2. për të siguruar mbrojtjen e duhur fizike të ambienteve dhe infrastrukturës së tyre kritike;</p> <p>1.3. për të reaguar, rezistuar dhe për të zbutur pasojat e incidenteve, duke marrë parasysh zbatimin e procedurave dhe protokolleve të menaxhimit të rrezikut dhe krizës si dhe alarmet paralajmëruese;</p> <p>1.4. për rikuperim nga incidentet, duke marrë parasysh masat e vazhdimësisë së biznesit dhe identifikimin e zinxhirëve alternativë të furnizimit, për të mundësuar rifillimin e ofrimit të shërbimit esencial;</p> <p>1.5. për të siguruar menaxhim adekuat të sigurisë së punonjësve, duke marrë parasysh masat si përcaktimi i kategorive të personelit që ushtrojnë funksione kritike, lejimi i qasjes në ambiente, infrastrukturë kritike dhe informacione të ndjeshme, krijimi i procedurave për verifikimin e sigurisë, përcaktimi i kategorive të personave të cilëve u kërkohet t'i nënshtrohen verifikimit të sigurisë, si dhe</p>	<p>1.1. for incident prevention, taking due account of measures for disaster risk reduction and climate adaptation;</p> <p>1.2. to ensure adequate physical protection of their premises and critical infrastructure;</p> <p>1.3. to respond to, resist and mitigate the consequences of incidents, duly considering the implementation of risk and crisis management procedures and protocols as well as alert routines;</p> <p>1.4. for recovery from incidents, duly considering business continuity measures and the identification of alternative supply chains, to enable the resumption of essential service provision;</p> <p>1.5. to ensure adequate management of employee security, duly considering measures such as defining the categories of personnel who exercise critical functions, allowing access to premises, critical infrastructure and sensitive information, creating procedures for security verification, defining the categories of persons required to undergo security clearance, as well as determining appropriate training requirements and</p>	<p>1.1. za sprečavanje incidenata, uzimajući u obzir mere za smanjenje rizika od nepogoda i klimatskih prilagođavanja;</p> <p>1.2. za obezbeđivanje adekvatne fizičke zaštite svojih prostorija i kritične infrastrukture;</p> <p>1.3. za reagovanje, odupiranje i ublažavanje posledice incidenata, uzimajući u obzir sprovođenje postupaka i protokola upravljanja rizicima i krizama kao i alarme upozorenja;</p> <p>1.4. za oporavak od incidenata, uzimajući u obzir mere poslovnog kontinuiteta i identifikaciju alternativnih lanaca snabdevanja, kako bi se omogućilo ponovno pokretanje pružanja osnovnih usluga;</p> <p>1.5. za obezbeđivanje adekvatnog upravljanja bezbednošću zaposlenih, uzimajući u obzir mere kao što su definisanje kategorija osoblja koje obavljaju kritične funkcije, odobravanje pristupa prostorijama, kritičnoj infrastrukturi i osetljivim informacijama, uspostavljanje postupaka za proveru bezbednosti, utvrđivanje kategorija lica od kojih se zahteva da se podvrgnu proveru bezbednosti, kao i utvrđivanje</p>
---	---	--

<p>përcaktimi i kërkesave dhe kualifikimeve të duhura të trajnimit;</p> <p>1.6. për të rritur ndërgjegjësimin për masat e përmendura në nënparagrafin 1.1. deri 1.5. të këtij paragrafi për personelin përkatës, duke marrë parasysh kurset e trajnimit, materialet informative dhe ushtrimet;</p> <p>1.7. Për qëllim të nënparagrafit 1.5. të këtij paragrafi, autoriteti kompetent siguron që entitetet kritike kur përcaktojnë kategoritë e personelit që ushtrojnë funksione kritike të përfshijnë edhe ofruesit e jashtëm të shërbimeve.</p> <p>2. Entitetet kritike duhet të kenë dhe të zbatojnë një plan të qëndrueshmërisë ose dokument apo dokumente ekuivalente që përshkruajnë masat e marra në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>3. Kur entitetet kritike kanë hartuar dokumente ose kanë marrë masa në përputhje me detyrimet e përcaktuara në akte të tjera ligjore që përfshijnë masat sipas paragrafit 1 të këtij neni, ato mund t'i përdorin ato dokumente dhe masa për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në këtë nen.</p> <p>4. Autoriteti kompetent mund të konstatojë se dokumentet ose masat sipas paragrafit 3 të këtij</p>	<p>qualifications;</p> <p>1.6. to raise awareness of the measures mentioned in sub-paragraphs 1.1. until 1.5. of this paragraph among relevant personnel, duly considering training courses, informational materials and exercises;</p> <p>1.7. For the purpose of sub-paragraph 1.5. of this paragraph, the competent authority shall ensure that the critical entities also include external service providers when defining the categories of personnel performing critical functions.</p> <p>2. Critical entities must have and implement a resilience plan or equivalent document or documents describing the measures taken in accordance with paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. When critical entities have drawn up documents or taken measures in accordance with the obligations set forth in other legal acts that include measures under paragraph 1 of this Article, they may use those documents and measures to meet the requirements set forth in this Article.</p> <p>4. The competent authority may establish that the documents or measures according to</p>	<p>odgovarajućih uslova i kvalifikacija za obuku;</p> <p>1.6. za podizanje svesti o merama navedenim u tački 1.1. do 1.5. ovog stava za relevantno osoblje, uzimajući u obzir kurseve obuke, informativne materijale i vežbe;</p> <p>1.7. za potrebe tačke 1.5. ovog stava nadležni organ obezbeđuje da kritični subjekti prilikom definisanja kategorija osoblja koje obavljaju kritične funkcije uključuju i spoljne pružaoce usluga.</p> <p>2. Kritični subjekti treba da imaju i da sprovede plan održivosti ili dokument ili ekvivalentne dokumente koji opisuju preduzete mere u skladu sa stavom 1. ovog člana.</p> <p>3. Kada su kritični subjekti izradili ili preduzeli mere u skladu sa obavezama utvrđenim u drugim zakonskim aktima, koje uključuju mere iz stava 1. ovog člana, one mogu koristiti te dokumente i mere za ispunjavanje uslova utvrđenih ovim članom.</p> <p>4. Nadležni organ može da konstataje da su dokumenti ili mere iz stava 3. ovog člana, su u</p>
---	--	--

<p>neni janë në përputhje, tërësisht ose pjesërisht, me detyrimet nga ky nen.</p> <p>5. Çdo entitet kritik cakton një pikë kontakti me autoritetin kompetent.</p> <p>6. Procedura për zbatimin e këtij neni rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga autoriteti kompetent.</p>	<p>paragraph 3 of this Article are in accordance, in whole or in part, with the obligations set forth in this Article.</p> <p>5. Each critical entity shall designate a point of contact with the competent authority.</p> <p>6. The procedure for implementing this Article shall be regulated by a sublaw issued by the competent authority.</p>	<p>skladu, u potpunosti ili delimično, sa obavezama iz ovog člana.</p> <p>5. Svaki kritični subjekat određuje kontakt tačku sa nadležnim organom.</p> <p>6. Postupak za sprovođenje ovog člana uređuje se podzakonskim aktom koji donosi nadležni organ.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Verifikimi i sigurisë</p> <p>1. Autoriteti kompetent mund t'i kërkojë një entiteti kritik, në rastet e arsyetuara dhe duke marrë parasysh vlerësimin shtetëror të rrezikut, të paraqesë kërkesë për verifikim të sigurisë për personelin që:</p> <p>1.1. mban rol të ndjeshëm në ose në dobi të entitetit kritik, veçanërisht në lidhje me qëndrueshmërinë e entitetit kritik;</p> <p>1.2. është i autorizuar të ketë qasje direkt ose në distancë në mjediset e tij, informacionin ose sistemet e kontrollit, përfshirë në lidhje me sigurinë e entiteti kritik;</p> <p>1.3. është duke u shqyrtuar për rekrutim në pozicione që janë nën kriteret e</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Security verification</p> <p>1. The competent authority may request a critical entity, in justified cases and taking into account the state risk assessment, to submit a request for security verification for personnel who:</p> <p>1.1. plays a significant role in or for the benefit of the critical entity, particularly in relation to the resilience of the critical entity;</p> <p>1.2. is authorized to have direct or remote access to its premises, information or control systems, including in relation to the security of the critical entity;</p> <p>1.3. is being considered for recruitment in positions that are under the criteria defined in sub-paragraphs 1.1 and 1.2 of</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Provera bezbednosti</p> <p>1. Nadležni organ može zatražiti od kritičnog subjekta, u opravdanim slučajevima i uzimajući u obzir državnu procenu rizika, da podnese zahtev za proveru bezbednosti za osoblje koje:</p> <p>1.1. ima značajnu ulogu u ili u korist kritičnog subjekta, posebno u vezi sa održivošću kritičnog subjekta;</p> <p>1.2. ovlašćeno je da ima direktan ili pristup na daljinu njenim prostorijama, informacijama ili kontrolnom sistemu, uključujući pristup u vezi sa bezbednošću kritičnog subjekta;</p> <p>1.3. koje se razmatra za zapošljavanje u radnim mestima koja su pod kriterijumima utvrđenim u tačkama 1.1 i 1.2 ovog stava.</p>

<p>përcaktuara në nënparagrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij paragrafi.</p> <p>2. Vlerësimi i sigurisë sipas këtij neni, bëhet në përputhje me ligjin përkatës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Njoftimi i incidentit</p> <p>1. Entitetet kritike duhet të njoftojnë autoritetin kompetent, pa vonesa të panevojshme, për incidentet që pengojnë ndjeshëm ose kanë potencialin të pengojnë ndjeshëm ofrimin e shërbimeve esenciale. Përveç rasteve kur nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë, entitetet kritike duhet të dorëzojnë një njoftim fillestar te autoriteti kompetent jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë pasi janë vënë në dijeni për një incident, i shoqëruar nga një raport i detajuar jo më vonë se një (1) muaj pas incidentit.</p> <p>2. Për të përcaktuar rëndësinë e një ndërprerjeje, duhet të merren parasysh sidomos parametrat e mëposhtëm:</p> <p>2.1. numri dhe përqindja e përdoruesve të prekur nga ndërprerja;</p> <p>2.2. kohëzgjatja e ndërprerjes;</p>	<p>this paragraph.</p> <p>2. The security assessment according to this Article shall be carried out in accordance with the relevant law on protection of classified information.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Incident notification</p> <p>1. Critical entities shall notify the competent authority, without undue delay, of incidents that significantly disrupt or have the potential to significantly disrupt the provision of essential services. Unless they are unable to do so, critical entities must submit an initial notification to the competent authority no later than twenty-four (24) hours after becoming aware of an incident, followed by a detailed report not later than one (1) month after the incident.</p> <p>2. In order to determine the importance of a disruption, the following parameters shall be considered in particular:</p> <p>2.1. the number and proportion of users affected by the disruption;</p> <p>2.2. the duration of the disruption;</p>	<p>2. Procena bezbednosti, u skladu sa ovim članom, vrši se u skladu sa relevantnim zakonom o zaštiti klasifikovanih informacija.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Obaveštavanje o incidentu</p> <p>1. Kritični subjekti treba da obaveste nadležnog organa, bez nepotrebnog odlaganja, o incidentima koji značajno ometaju ili imaju potencijal da značajno ometaju pružanje osnovnih usluga. Osim u slučajevima kada to nisu u mogućnosti da učine, kritični subjekti treba da daju preliminarno obaveštenje nadležnom organu najkasnije dvadeset četiri (24) sata nakon što su saznali za incident, praćen detaljnim izveštajem najkasnije jedan (1) mesec nakon incidenta.</p> <p>2. Za utvrđivanje važnosti prekida, treba posebno uzeti u obzir sledeće parametre:</p> <p>2.1. broj i procenat korisnika pogođenih od prekida;</p> <p>2.2. 1.2. trajanje prekida;</p>
---	---	---

<p>2.3. zona gjeografike e prekur nga ndërprerja, duke marrë parasysh nëse zona është e izoluar gjeografikisht.</p> <p>3. Njoftimet sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshijnë çdo informacion të disponueshëm të nevojshëm për t'i mundësuar autoritetit kompetent të kuptojë natyrën, shkakun dhe pasojat e mundshme të incidentit, duke përfshirë çdo informacion të disponueshëm të nevojshëm për të përcaktuar çdo ndikim ndërkufitar të incidentit. Njoftime të tilla nuk krijojnë bazë për të kërkuar detyrime shtesë nga entitetet kritike.</p> <p>4. Në bazë të informacionit të dhënë nga një entitet kritik në një njoftim siç përmendet në paragrafin 1 të këtij neni, autoriteti kompetent, nëpërmjet pikës së vetme të kontaktit, informon pikën e vetme të kontaktit të shteteve të tjera të prekura ku incidenti ka ose mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në entitetet kritike dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve thelbësore për ose në një ose më shumë shtete tjera.</p> <p>5. Pika e vetme e kontaktit secilin informacion të dërguar dhe pranuar e trajton me konfidencialitet dhe e mbrojnë sigurinë dhe interesin tregtar të subjektit kritik në fjalë.</p>	<p>2.3. the geographic area affected by the disruption, taking into account whether the area is geographically isolated.</p> <p>3. Notifications under paragraph 1 of this Article shall include any available information necessary to enable the competent authority to understand the nature, cause and possible consequences of the incident, including any available information necessary to determine any cross-border impact of the incident. Such notices do not create a basis for demanding additional obligations from critical entities.</p> <p>4. Based on the information provided by a critical entity in a notification as referred to in paragraph 1 of this Article, the competent authority shall, through its single point of contact, inform the single point of contact of other affected states where the incident has or may have a significant impact on critical entities and the continuity of the provision of essential services to or in one or more other states.</p> <p>5. The single point of contact shall treat all information sent and received with confidentiality and protect the security and commercial interest of the critical entity concerned.</p>	<p>2.3. geografsko područje pogođena od prekida, uzimajući u obzir ako je područje geografski izolovano.</p> <p>3. Obaveštenja iz stava 1. ovog člana obuhvataju sve dostupne informacije neophodne da bi se omogućilo nadležnom organu da razume prirodu, uzrok i moguće posledice incidenta, uključujući sve dostupne informacije potrebne za utvrđivanje bilo kakvog prekograničnog uticaja incidenta. Ovakva obaveštenja ne stvaraju osnov za traženje dodatnih obaveza od kritičnih subjekata.</p> <p>4. Na osnovu informacija koje je kritični subjekat dalo u obaveštenju, kao što je navedeno u stavu 1. ovog člana, nadležni organ, preko jedinstvene kontakt tačke, obaveštava jedinstvenu kontakt tačku drugih pogođenih zemalja, u kojima incident može ili bi mogao da ima značajan uticaj na kritične subjekte i kontinuitet u pružanju osnovnih usluga u jednoj ili više drugih zemalja.</p> <p>5. Jedinstvena tačka kontakta tretira sve informacije koje se šalju i primaju poverljivo i štiti bezbednost i komercijalni interes dotičnog kritičnog subjekta.</p>
--	---	--

